

1-Prokuroria e Posaçme në akuzat e ngritura ka argumentuar se ka pasur një përpjekje të bashkërenduar mes z. Malltezi, z. Fatmir Bektashi e z. Xhimi Begeja si përfaqësues të palës pronare dhe ju z. Berisha, si kreu i qeverisë atë kohë, për të mundësuar kthimin e shpejt, ndërmjet favorizimit me anë të ligjeve të duhura në momentin e duhur -t të pronave të pretenduara në 2 Klubet Partizani, ndryshimin e destinacionit të tyre për të mundësuar zhvillimin e tyre dhe dorëzimin në dëm të buxhetit të shtetit. Nga verifikimet tona, rezulton se vendimet e marra prej jush kanë dal pikërisht në kohën kur zhvilloheshin procedurat për kthimin dhe privatizimin e ish- Komplexit Partazani. Zoti Berisha, si do e komentoni ju faktin që këto procedura ligjore të miratuara me firmën tuaj përkojnë pikërisht në kohën kur dhëndri juaj, Z. Malltezi mori tagra përfaqsimi për kthimin, ndryshimin e destinacionit dhe zhvillimin e pronës në fjalë?

Në krye të radhës dua të theksoj se dokumenta zyrtare të pa kundërshtueshme provojnë se aktakuza e Prokurorisë së Posaçme politike ndaj Sali Berishës është fund e krye një piramidë mashtrimi, e ndërtuar mbi shpifjen, fallsifikimin, fshehjen e qindra dokumenteve zyrtare dhe manipulimin e tyre.

Dokumente publike, gjithashtu, faktojnë se arrestimi i Sali Berishës erdhi pas kërkesave publike të përsëritura ndaj SPAK të Edi Ramës dhe diplomatëve dhe zyrtarëve të korruptuar Eskobar, Juri Kim dhe Mc Gonigal.

Lidhur me këtë pyetje shtoj se është absolutisht mashtrim. Dokumentat zyrtare dëshmojnë se nuk ka patur asnjë përshpejtim të këtij procesi dhe se Sali Berisha nuk ka firmosur asnjë ligje apo vendim nominativ. Le t’ju referohemi dokumenteve.

Familjet pronare, ndër to dhe familja Begeja kanë marrë njohjen dhe pjesërisht kthimin fizik të pronësisë së tyre mbi tokën në vitin 1996 dhe në vijim. Ligji i kohës atëherë kufizonte kthimin fizik të pronës në 5000m² dhe pastaj në 10.000m². Duke qenë se kjo familje mori dhe prona të tjera në Tiranë, nuk mund të kërkonte më shumë kthim fizik në terrenet e ish-klubit Partizani (KP) nga çfarë mori me vendimin e vitit 1996 (rreth 2,335m²). Kjo situatë vazhdoi deri në vitin 2004, kur ligji i miratuar nga mazhoranca socialiste hoqi kufirin për kthimin fizik.

Pas kësaj familjet pronarët vijuan me kërkimin për kthimin e pronës tek ish-Klubi Partizani.

Nga toka që u ishte njohur qysh në 1996, atyre iu kthye një pjesë e tokës (11,740m²) me vendimin nr. 135, datë 20.01.2006, nga KKP e përbërë nga të gjithë anëtarët të zgjedhur nga mazhoranca e mëparshme socialiste dhe më pas me vendimin nr. 6, datë 21.03.2007 të AKKP ju kthye edhe pjesa e mbetur prej rreth 12,500m²). Të gjitha vendimet e KKP dhe AKKP kanë qenë vendime plotësuese të njeri-tjetrit sepse prona ka qenë njohur kategorikisht qysh në 1996 nga disa komisione dhe me daljen e ligjit që hoqi kufizimin e kthimit fizik atyre ju kthye pjesë-pjesë prona e tyre.

Pra, procesi për kthimin e pronave të familjes Begeja ka zgjatur 12 vjet.

Në mënyrë të ngjashme edhe familjet e tjera pronare kanë marrë vendimet e tyre të njohjes dhe kthimit të pronave qysh nga viti 1995 deri në 2007. Duhet thënë se të gjitha tokat në atë territor sipas dokumentave dhe matjeve të Italianëve në 1940 janë private dhe kufitare me njëra-tjetrën, pra pa hapësira.

Nga viti 2005 gjer në vitin 2013 nuk ka patur kurrë ligje apo vendime nominative për reformën e pronësisë për individë apo grupe të vogla.

Ndryshimet ligjore të vitit 2006 nuk e bënë me të lehtë, por i shtrenguan filtrat e kontrollit të vendim-marrjes së AKKP si dhe zgjaten afatet për marrjen e vendimit nga 2 në 3 muaj. Ato ishin ndryshime ligjore të ligjeve sektoriale, që synonin zbatimin e programit të koalicionit qeverisës dhe premtimet elektorale në lidhje me pronat dhe nuk favorizonin askënd. Komisionet e kthimit të pronave merrnin vendime quasi gjyqësore që rregjistroheshin menjëherë, ndërsa me krijimin e AKKP ajo u detyrua që çdo vendim para se të merrte formë të prerë të çohet për rishikim në Agjencinë qendrore si edhe në Avokaturën e Shtetit, pra 2 filtra shtesë; vendimi do merrte formë të prerë veç nëse nuk do kishte ndonjë vërejtje nga këto 2 filtra shtesë. SPAK ka konfirmuar në dosje që çdo vendim të këtyre familjeve pronare është dërguar me protokoll edhe në zyrën qendrore edhe në Avokaturën e Shtetit, sipas parashikimeve ligjore.

Pas krijimit të AKKP në vitin 2006, kjo e fundit nuk dha vendime për shumë muaj derisa plotësoi bazën nënligjore të vendimarrjes së saj dhe më pas në periudhën mars-tetor 2007 dha menjëherë 189 vendime. Në total në vitet 2007-2013 AKKP ka dhënë rreth 54.000 vendime, për 510.000 pronare tokash të shpronësuar nga

rregjimi komunist, të cilët morën me kthim ose kompensim rreth 1 miliard e 700 milionë m² tokë, nga të cilët dhëndri im ka marrë 410m².

Ndaj akuza se AKKP ka marrë vendime me shpejtësi është e pabazuar është trillim. Procesi i kthimit të pronës ka zgjatur mbi 12 vjet. Edhe kërkesa e familjes Begeja në Tetor 2005 u plotësua pjesërisht veç për 11,740m² nga prona e njohur ndërkohë që sipas ligjit duhej të ishte kthyer plotësisht. AKKP në 2007 vendosi mbi të njejtën dosje që ishte përdorur nga KKP e mëparshme, pra praktika kish qenë e gatshme dhe ishte ripërpunuar gjatë periudhës kur AKKP ishte në pritje të plotësimit të bazës nënligjore.

Në lidhje me privatizimin

Një shpifje tjetër e madhe mbi të cilën është ngritur pramida e mashtrimit lidhet me pretendimin se Berisha privatizoi Klubin Partizani për të pasuaruar dhëndrin e tij. Dokumentat zyrtare dhe ligjet e kohës faktojnë se kemi të bëjmë një shpifje dhe fallsifikim.

Familja Begeja ka fituar titullin e njohjes dhe kthimit të pjesshme fizik të tokës në fjalë që prej viteve '95-'96 e në vijim. Me vendimin e njohjes në përputhje me ligjin e kohës familjet fituan edhe të drejtën e parablerjes së klubeve në rast privatizimi. Me këtë të drejtë ata i janë drejtuar organeve shtetërore vazhdimisht për të kërkuar privatizimin e klubit (shih grupin foto1 bashkangjitur). Në të njejtën kohë privatizimin e klubit e kërkonte edhe një subjekt privat i cili e shfrytëzonte atë pa pasur tagra ligjore, pra pa një kontratë me shtetin.

Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave (LKKP), i miratuar në vitin 2004 nga mazhoranca socialiste, parashikonte në nenin 7/1 kategorinë e pronave që nuk ktheheshin. Në paragrafin e 2 të këtij neni ai parashikonte se edhe pronat që nuk ktheheshin, pra, që listoheshin në nenin 7/1 në momentin kur propozoheshin të tjetërsoheshin, i kalonin ish-pronarit.

Kjo dispozite kishte pasojë që shteti nuk mund të tjetërsonte asnjë pronë të

ish-pronareve përveçse duke ua kthyer atyre. Pra, në çdo procedurë privatizimi, koncesioni, enfiteose, etj, përparësi kishte kthimi i tokës tek ish-pronaret dhe e drejta e parablerjes së objekteve nga ata.

VKM nr. 515, datë 18.07.2003 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së

Mbrojtjes” e liston Klubin Partizani (KP) nën asetet që u liheshin në dispozicion për përdorim ministrive të ndryshme. Kjo do të thotë që KP nuk kishte funksion për mbrojtjen e vendit dhe mund të privatizohej.

Në korrik 2005, ministri socialist Anastas Angjeli i propozon ministrave Blendi Klosi dhe Pandeli Majko privatizimin e klubit Partizani (shih grupi foto2 bashkangjitur). Procedura e privatizimit në fjalë pra, nisi nga qeveria socialiste, pas kërkesës së subjektit që shfrytëzonte objektin pa pasur tagra ligjore. Që në këtë moment, neni 7§2 i Ligjit të Kthimit të Pronave i 2004 i jepte pronarëve të drejtën e parablerjes së objekteve në pronën e tyre. Pra, privatizimi i KP-së filloi gjatë qeverisjes së mazhorancës socialiste dhe po aty e drejta e familjeve pronare për privatizim.

Me fillimin e punës së qeverisë së PD-së, i njëjti subjekt privat kërkon në Ministrinë e Mbrojtjes (MM) privatizimin e KP-së. Ministri Mediu dhe Ruli zhvillojnë korrespondencë gjatë vjeshtës 2005 (të administruar në dosje), në lidhje me privatizimin e KP-së. Më 4 Janar 2006 z.Mediu jep një intervistë tek Gazeta Shqiptare ku flet për privatizimin e KP-së, nga ku ish-pronarët informohen dhe i shkruajnë ministrit duke e informuar për të drejtën e tyre të parablerjes në rast privatizimi. E njëjta gjë vlen dhe për Klubin shumësportesh Partizani (KSHP) edhe ky pjesë e ish-KP-së. (referuar përgjigjes së Blendi Klosit, korrik 2005).

Që nga momenti kur familjeve ish-pronare u kish lindur e drejta sipas nenit 7§2 të LKKP, asnjë ndryshim ligjor i mëpasshëm, përfshirë dhe ato që pretendohen për ligjin e sportit, nuk mund të kishin efekt prapaveprues, përveçse kur ligji vetë parashikonte të kishte efekt prapaveprues, gjë që nuk ishte rasti.

Dhe në çdo rast, ndryshimi i ligjit të sporteve në 2007, u duk shpejt që ishte i pazbatueshëm, për shkak të nenit 7§2 të ligjit KKP miratuar nga mazhoranca socialiste në 2004, sipërcituar, i cili në momentin e propozimit (pra, jo të tjetërsimit, por të propozimit) për tjetërsim të pronës i jepte të drejtë vetëm pronarit. Që do të thotë se dhënia me koncesion të tretëve e terrenëve sportive ishte e perealizueshme për shkak të veprimt të ligjit për pronat.

Pretendimet për përsheptimin e privatizimit të KP janë të pavërteta. Privatizimi i KP filloi në 2005 dhe përfundoi në 2009 për KFP dhe në 2008 për KSHP. Pra, privatizimet kanë zgjatur mbi 3 dhe 4 vite, ose 3-4 herë më tepër se procedura të tjera privatizimesh për objekte të tjera në zonë.

2. Referuar shprehjes “Nga verifikimet tona, rezulton se vendimet e marra prej jush kanë dal pikërisht në kohën kur zhvilloheshin procedurat për kthimin dhe privatizimin e ish- Kompleksit Partazani. Zoti Berisha, si do e komentoni ju faktin që këto procedura ligjore të miratuara me firmën tuaj përkojnë pikërisht në kohën kur dhëndri juaj, Z. Malltezi mori tagra përfaqsimi për kthimin, ndryshimin e destinacionit dhe zhvillimin e pronës në fjalë?”

Nuk ka asnjë firmë të Sali Berishës në procesin e kthimit të pronës dhe privatizimit të KP. Mbetëm i hapur t’u përgjigjem provave konkrete nëse keni. Por në fakt një gjë e tillë nuk pretendohet as në dosjen e SPAK. Sikundër buxheti i shtetit nuk ka humbur asnjë qindarkë nga ky privatizim sepse të gjitha të ardhurat përfundonin në buxhetin e xhepit dhe informalitetit.

Në lidhje me vendimet e mia si kryetar i KRRTRSH si dhe kohën e marrjes së tagrave përfaqësues nga dhëndri im prej familjes s tij, sqaroj sa më poshtë, duke nisur nga kjo e fundit:

(i) çdo familje pronare është e lirë të zgjedhë përfaqësuesin e vet. Tagrat e përfaqësimit Jamarbër Malltezi (JM) i ka pasur në vijimësi që prej kthimit të tij nga Kosova. Pas vdekjes së gjyshes së tij ai mori tagra më të plota përfaqsimi, pas çeljes së trashëgimisë. Theksoj se ai i ka pasur këto tagra vetëm për familjen e tij dhe në të njejtën kohë kur, edhe anëtarë të tjerë të familjes Begeja kishin tagra të njejtë përfaqsimi. SPAK i referohet në akuzë datës së çeljes së trashëgimisë, por këtë e përcakton gjykata dhe nuk ka asnjë lidhje me dëshirën e palëve apo vendimarrjen time si KM.

(ii) Në lidhje me akuzën se unë kam ndryshuar destinacionin e zonës së KP dhe vendimarrjen time si kryetar i KRRTRSH ne 2006 (shih foto3 bashkangjitur).

Prokuroria politike ka falsifikuar dokumenta zyrtare pr të mbështetur këtë akuzë, ndonëse ato dokumenta provojnë pikërisht të kundërtën.

SPAK pretendon se Berisha e ka ndryshuar destinacionin si kryetar i KRRT. Për ata që nuk e dinë, KRRT në atë kohë ka qenë organi kolegjal i bashkive që merrej më çështje të rregullimit të territorit. Ky organ drejtohej nga kryetari i bashkisë, që në

atë kohë në Tiranë, ka qenë Edi Rama. Sali Berisha nuk ka qenë kurrë kryetar bashkie, e për rrjedhojë nuk ka qenë kurrë kryetar KRRT-së.

Ky nuk është një lapsus i prokurorëve politikë, por një falsifikim i dokumentit zyrtar. Dy paragrafe më poshtë ata shpjegojnë pse e quajnë Sali Berishën kryetar të KRRT. Kjo sepse, sipas tyre, KRRT e Bashkisë Tiranë (BT) në atë kohë ishte e kontrolluar nga mazhoranca e djathtë.

Kjo është e vërtetë (sipas ligjit të urbanistikës së 1998, të miratuar nga qeveria e PS), por gjithashtu është e vërtetë që KRRT shqyrtonte vetëm dosjet që i dërgoheshin nga këshilli teknik i bashkisë, i përbërë nga drejtorët e BT, të emëruar ekskluzivisht nga Edi Rama. Askush nuk mund të vendoste mbi një çështje që nuk miratohej paraprakisht nga këshilli teknik dhe nuk kishte asnjë mekanizëm që ta detyronte këshillin teknik të dërgonte një projekt për miratim në KRRT. **Pra, ky ishte një proces kryekëput i kontrolluar nga Edi Rama.**

Krejt papritur, pa asnjë kërkesë nga pala pronare, pa kërkesë nga firma ndërtuese, dhe pa asnjë kërkesë nga ndonjë institucion. Edi Rama vendosi nëpërmjet vendimit të këshillit teknik të BT, datë 12.5.2006 (shih foto 3 bashkëngjitur) të ndryshojë destinacionin e një pjese të ish-kompleksit Partizani, nga zonë sportive në zonë banimi. Fakti që kjo u bë pa ndërhyrjen e palëve të sipërpërmendura vërtetohet me faktin se, siç pranohet edhe nga SPAK, vetëm në datë 22.5.2006 (pra 10 ditë më pas), familjet pronare që nuk e dinin çfarë kishte ndodhur, lidhin kontratë sipërmarrje me një firmë ndërtuese (Kontakt) (shih foto 3 bashkëngjitur), ku i japin kësaj të drejtën të kërkojë ndryshimin e destinacionit të zonës dhe lejet e ndërtimit. Pra, qartazi në këtë datë, ky fakt ishte ende i panjohur për familjet pronare. Dy javë më pas, Edi Rama e fut projektin për ndryshimin e destinacionit për miratim në KRRT e BT ku ai dhe miratohet me vendimin 132 të KRRT, datë 08.06.2006, i cili mban firmën e Edi Ramës (shih foto 3 bashkëngjitur).

Çfarë halli i shtyn prokurorët e kapur të SPAK të fshehin dokumente që të gënjejnë? Pse nuk e thirrën kurrë Edi Ramën për ta pyetur pse e ndryshoi destinacionin e zonës pa kërkesë të pronarëve? Për llogari të kujt?

Edi Rama ka kryer 11 ndryshime destinacionesh, kryesisht nga zonë sportive në banimi, veç në vitin 2006 dhe KRRTRSH e kryesuar nga Sali Berisha ia ka miratuar të gjitha ndryshimet e destinacioneve që ka sjellë (veç tek vendimi në fjalë janë 4 ndryshime që ka miratuar KRRT Tiranës, se KRRTRSH nuk ka iniciuar kurrë asnjë ndryshim vetë – shih grupi foto 3 bashkëngjitur). Kjo sepse, pas prishjes së mbikalimit tek Zogu i Zi në 2005, Edi Rama solli më 16.01.2006

Giovanni di Stassi (ish-president i Komitetit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës), që deklaroi se qeveria shqiptare në rastin e Zogut të Zi kish shkelur Kartën Europiane të Autonomisë Vendore të Këshillit të Evropës (e detyrueshme për Shqipërinë), sipas të cilës planifikimi dhe kontrolli i territorit janë tagër i pushtetit vendor (shih foto 3 bashkëngjitur). Kjo u bë refren i Edi Ramës dhe qeveria zgjodhi të mos dilte kundër Kartës, që ishte pjesë e Këshillit të Evropës. Kjo u pa qartë edhe me Vendimin nr. 24, datë 10.11.2006 dhe 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese.

Ndërkohë që Edi Rama e kaloi ndryshimin e destinacionit për 3 javë, Sali Berisha nuk e bëri këtë edhe për 6 muaj të tjerë.

Gjykata Kushtetuese mori qëndrim të qartë për pavarësinë e kompetencave të KRRT dhe kufizimin e atyre të KRRTRSH. Fillimisht me vendimin nr. 24 të fillimit të nëntorit 2006, ku i deklaroi të pavlefshme vendimet e marra në zbatim të një akti normativ të miratuar nga qeveria, që i jepte tagra prefektit të ndërhynte në vënien në lëvizje të KRRT. Më pas, në vendimin nr. 29 të dhjetorit 2006, kjo gjykatë përcaktoi se KRRTRSH nuk mund të anulonte planet urbanistike të bashkive edhe kur ato ishin në kundërshtim me ligjin, pasi një gjë e tillë ishte kompetencë vetëm e gjyqësorit.

Kush paska pasur pra interes në ndryshimin e destinacionit, Edi Rama që e kaloi ndryshimin për tre javë apo Sali Berisha që priti 6 muaj dhe i ka miratuar *ex lege* të gjitha 11 ndryshimet e destinacionit që vendosi Edi Rama në 2006?

Për më tepër, pikërisht në këtë tokë Edi Rama vetë ka firmosur lejen e sheshit të ndërtimit më 29.12.2007, kohë kur kishte edhe këshillin teknik edhe shumicën në KRRT (shih foto 4 bashkëngjitur).

Më tej, lidhur me ndryshimin e destinacionit në 2008, ka edhe më shumë thagma. Në akuzën 500-faqëshe, apo manualin ‘Si të mashtrojmë me mediokritet’, SPAK shkruan se z. Bektashi në kontratat me familjet pronare në 2007 & 2008 mori përsipër ndryshimin e destinacionit të gjithë zonës së madhe dhe se këtë e realizoi Berisha në 2013, pra 6 vjet më vonë!

Pra e para, nuk paska qenë Jamarbër Malltezi ai që ka marrë përsipër ndryshimin e destinacionit, por ndërtuesi. A nuk është kjo një marrëveshje standarde e pronarëve të truallit me ndërtuesit?

E dyta dhe më qesharakja, nëse nuk do të ishte dramatike për nivelin e kapjes së drejtësisë: SPAK thotë se destinacionin e pjesës së mbetur të terrenit të ish-klubit

Partizani e ndryshoi Sali Berisha me vendim të KKT të vitit 2013. Fshehja e informacionit me qëllim shtrembërimin e përmbajtjes dhe/ose të vërtetës është definicioni ligjor i falsifikimit të dokumentit zyrtar.

Destinacionin e pjesës së mbetur të terrenit të ish-KP e ndryshoi Edi Rama me vendimin e KRRT nr. 238, datë 27.12.2008, të firmosur nga ai vetë, dhe 10 drejtorë të tij, të cilët miratuan zonimin funksional të kompanisë Urbaplan dhe e ndryshuan destinacionin e pjesës tjetër në “zhvillime të reja me parametra të lartë urbanë” (shih grupi i foto 5 bashkëngjitur). Sipas vendimit nr. 29 të dhjetorit 2006 të Gjykatës Kushtetuese, planifikimi i territorit ishte tagër i pushtetit vendor, ndaj vendimi i KRRT për zonimin funksional që e caktoi zonën si “U12 – Zhvillime të reja me parametra urbanë të lartë” hyri në fuqi dhe nuk mund të rrëzohej përveçse me vendim gjykatë. Ky zonim funksional u integrua më vonë në dokumentet e Planit të Përgjithshëm Rregullues të Tiranës të vitit 2012, i cili u miratua me vendimin nr. 57 të Këshillit Bashkiak të Tiranës të vitit 2012.

Sali Berisha, si kryetar i Këshillit Kombëtar të Territorit në shkurt të 2013, miratoi *ex lege* vendimin në fjalë të Këshillit Bashkiak mbi Planin Rregullues të gjithë Tiranës dhe jo specifikisht në lidhje me zonën e Klubit Partizani dhe nuk kishte asnjë mundësi tjetër.

Por vetëm prokuroria politike mund të jetë kaq mediokre sa të mos shohë se, Berisha, të cilin SPAK e akuzon për korrupsion pasiv se paska ndryshuar destinacionin, jo vetëm që nuk e ka bërë këtë, pasi vendimi është marrë nga Rama në 2008, por nuk e paska pasur hiç me ngut, pasi paska pritur plot 5 vite për të miratuar vendimin e Edi Ramës në lidhje me ndryshimin e dytë të destinacionit.

Akuza për ndryshim të ligjeve dhe akteve nënligjore në favor të familjes Begeja dhe familjeve të tjera ish-pronare

Thelbi i akuzës së SPAK është se unë kam miratuar ligje për të favorizuar dhëndrrin në këtë proces. Kjo është shpifje dhe provat e sjella nga SPAK lehtësisht provojnë të kundërtën e pretendimit të tyre.

Edhe njëherë theksoj se gjatë gjithë qeverisjes sime nuk është miratuar asnjë ligj nominativ, për person apo grup të ngushtë personash. Ligjet e përmendura nga SPAK janë ligje programatike, për të cilat koalicioni i PD u votua dhe erdhi në pushtet në 2005. Ato kanë të bëjnë me sektorin e pronave, sporteve, përdorimin e

letrave të privatizimit dhe fshirjen e mbivendosjeve në regjistrimin e pronave të paluajtshme në ZRPP.

Si provë, SPAK ka sjellë diskutimet e deputetëve në Komisionin e Ligjeve për miratimin e ndryshimeve për ligjin për pronat. Ato diskutime provojnë se iniciuesi i ndryshimeve ka qenë PR, që kishte dhe shtyllë kryesore të programit kthimin e pronave për ish-pronarët. Kalimi i varësisë të organit të KKP nga komision në agjenci të varur nga KM është pjesë e riorganizimit me qëllim forcimin e llogaridhënies për një sektor që kish qenë pjesë e programit të votuar të PD.

Parimi i ndarjes së pushteteve është shkelur në mënyrën më flagrante që kur SPAK ndërmerr të vlerësojë nëse ndryshime të tilla ishin apo jo të nevojshme, apo kur thërret një deputet të Kuvendit të Shqipërisë për ta pyetur pse ka thënë apo ka votuar si deputetët, në shkelje flagrante të nenit 73 të Kushtetutës.

Përmend që sot ATP ka të njëjtën varësi dhe kompetenca si dhe ato të AKKP.

Por urrejtja e prokurorëve ka shkuar deri aty sa shkruajnë: “Pra qartësisht duket qëllimi i qeverisë që trualli t’u kthehet ish-pronarëve.” Po natyrisht, pronarëve duhet t’u kthehet gjëja që iu grabit atyre.

Në lidhje me ndryshimet e ligjit për sportet, që u shpjeguan dhe më lart, ato nuk afektonin privatizimin e nisur të KP ndaj nuk ka pasur asnjë favorizim në këtë sens.

Por theksoj se qartazi ndryshimi i vitit 2007 ishte i pazbatueshëm për shkak të përplasjes me nenin 7 § 2 të LKKP të vitit 2004, dhe për këtë arsye u ndryshua në vitin 2008 për t’u sjellë në formën që kish pasur. Nëse qëllimi im do të kish qenë favorizimi i dhëndrrit, kjo mund të kish ndodhur edhe nëpërmjet koncesionit (ia jepja me PPP, koncesion apo me 1 euro, siç ia dha Edi Rama vëlla Olsit me VKM 283 të 2006), por unë kurrë nuk jam angazhuar në praktika të ndryshimit apo miratimit të ligjeve për interesa personash apo grupesh.

Në lidhje me VKM për bonot e privatizimit, ato janë përdorur për herë të parë në mesin e viteve ’90 gjatë qeverisjes së PD dhe më pas, qeveri të majta dhe të djathta kanë zgjatur hera-herës afatin e përdorimit të tyre, sipas nevojës për t’i vënë ato në qarkullim dhe për t’i mbledhur. Së fundmi, një tjetër zgjatje e bëri Partia Socialiste në pushtet para disa muajsh.

SPAK fsheh faktin se miratimi i VKM u bë pak javë pasi ish-pronarët e KP kishin paguar rreth 90% të parave të privatizimit me lekë (bankë), gati 720 mijë USD nga

800 mijë në total. (Klubi shumësportësh që kish më shumë objekte – ndonëse të rrënuara dhe të uzurpuara – u vlerësua për afro 700,000 USD dhe u pagua e gjitha me para në bankë, ndërsa te Klubi i Futbollit që kish veç 1 ndërtesë që u vlerësua diçka mbi 100,000 USD, u pagua diçka mbi 20,000 USD me para dhe rreth 80,000 USD me letra me vlerë).

Pra, nuk ka pasur asnjë informacion të brendshëm (se pronarët do kishin pritur 1 muaj dhe e kishin paguar pjesën më të madhe me letra me vlerë apo jo), e jo më favorizim të kësaj familjeje.

Nga pjesa e mbetur për të cilën u pagua me letra me vlerë, familja e dhëndrrit tim kishte vetëm 4% të objektit, dhe pjesa takuese e përfitimit të dhëndrrit tim ishte 62 USD (afërsisht).

SPAK falsifikon, dhe për këtë është përgatitur kallëzimi penal, kur thotë se vetëm pas 7 muajsh, pra pasi mbaroi punë JM me privatizimin, VKM në fjalë u ndryshua sërish me anë të VKM nr. 738 dhe hoqi nga përdorimi bonot e privatizimit (faqe 22, aktakuza SB). Mashtrim!

E vërteta është që kjo e fundit ndryshoi vetëm një pikë të VKM-së së mëparshme dhe u hoq paragrafi i parë që kishte të bënte me përdorimin e bonove të privatizimit për blerjet në ankand. Ndërsa paragrafi në lidhje me përdorimin e bonove nga ish-pronarët mbeti njësoj. (Shih Fletore Zyrtare 116, datë 31.07.2009).

Në lidhje me udhëzimin për fshirjen e mbivendosjeve në ZRPP, ai ishte një akt i iniciuar nga sektori përkatës (drejtori i ZRPP, ministri i linjës) në përgjigje të problematikave në të gjithë Shqipërinë. Në rastin e privatizimit të KP, një nga asetet e klubit, pishina, kishte mbivendosje dhe kur u panë dokumentat e regjistrimit të pronës nga pala tjetër, u pa se regjistrimi nuk kishte dokumenta të origjinës së pronës, pra kish qenë një falsifikim. SPAK fsheh faktin që edhe pas udhëzimit, familjet ish-pronare të KP nuk e morën pronën por u endën për 7 vite në gjyqe, ndonëse e kishin paguar pishinën, derisa me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit të vitit 2017 (shih Foto 6 bashkëngjitur) u rikonfirmua se regjistrimi i palës tjetër mbi pronën kish pasur në bazë dokumente të falsifikuara.

3 - Referuar dosjes hetimore, familjet pronare Begeja, Llagami, Vaqarri, Saliaga dhe Alimehmeti, pas procesit të njohjes së pronës së tyre në vitet '90, nuk kanë bërë asnjë përpjekje tek institucionet për kthimin dhe kompesimin e plotë të kësaj prone, - deri në momentin ju, z. Sali Berisha, keni marr drejtimin e qeverisë, (interesimi i parë daton as një javë pasi PD-ja fitoi

zgjedhjet në korrik të 2005), - ku ju rezultoni një nga bashkëptonarët. Z. Malltezi, a janë këto fakte një koncidencë?

Ky është një mashtrim i akuzës që përgënjeshtrohet edhe nga dokumentat e dosjes. Siç theksova më sipër, familjet pronare kanë pasur kthim të pronës gjatë gjithë periudhës që prej 1995, me ndalesa të detyrueshme për shkak të kufirit për kthimin fizik të pronës, që siç e shpjegova më lart u hoq nga mazhoranca socialiste me ligjin e vitit 2004. Ndaj, veç pas vitit 2004 mund të kërkonin kthimin e tokës. Përveç kësaj, ata kanë bërë vazhdimisht kërkesa për privatizimin qysh në 1995, 1999, 2001, e më tej (shih grupin foto 7 bashkëngjitur).

4 - Justina Boriçi, drejtoresha e Agjencinë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave rezutonte një person që militonte në Partinë Demokratike, para se ajo merrte emërimin prej jush në këtë detyrë, në cilëinë e Kryeministrit. Sipas dëshmive të grupit të punës së ngritur në SPAK, - mes të cilëve persona që kanë rezultuar në raporte kontraktore me dhëndrrin tuaj z. Malltezi, dosja e parë që ky institucion ka shqyruar është ajo e ish-Kompleksit Parizani me kërkesë të grupit të ish - pronarëve, pjesë e të cilit është edhe dhëndri i juaj. Edhe kjo një rastësi z. Berisha?

Znj. Borici është një intelektuale e angazhuar politikisht, e ardhur në administratë nga bota akademike universitare me kontribut në sfera të ndryshme të ekzekutivit. Angazhimi i qytetarëve dhe intelektualëve në veçanti, është pjesë e demokracisë pjesëmarrëse dhe e llogaridhënies së politikës ndaj qytetarëve për vënien në zbatim të programit për të cilin partia qeverisëse është votuar.

Znj. Borici nuk ka njohje me dhëndrrin apo vajzën time. Ajo nuk ka përpiluar dosjen dhe nuk kam parë në akuzë të përmenden dëshmi që të thonë sa pretendoni ju.

Ka një dëshmi që i referohet faktit që nga drejtoresha e degës i janë dhënë disa dosje vartësve, ndër të cilat ajo e familjes Begeja, kur AKKP ka filluar të japë vendime.

Për këtë sqaroj se me futjen e kërkesës dosjet mbajnë një numër dhe familja Begeja ka qenë ndër familjet e para që ka futur dosjet, madje që në fillim të viteve '90.

Vendimet e AKKP kanë qenë jo mbi dosje të reja, por plotësim vendimesh të mëparshme. Pra nuk ka pasur përshpejtim të radhës së vendimmarrjes.

Për sa i përket afatit, AKKP ia ka dhënë vendim familjes Begeja në tejkalim të afatit ligjor 3-mujor të parashikuar në ligj. (Siç e thotë vetë akuza, kërkesa e familjes Begeja për plotësim u bë në tetor 2005 dhe iu kthye një pjesë në janar 2006 (në dhunim të afateve ligjore) dhe kërkesa e fundit për plotësim u bë në 12 tetor 2006 dhe vendimi u dha më 21 mars 2007). Ritheksoj atë që përmenda më lart, që del edhe nga dëshmitë e dosjes, se në pritje të plotësimit të bazës nënligjore, AKKP ka plotësuar dosjet dhe vendimet e saj, që më pas i ka miratuar sapo u miratua baza nënligjore; për këtë arsye, si asnjëherë tjetër për 6 muaj (mars–tetor 2007) janë dhënë gati 189 vendime.

5- Me vendim të Këshillit të Rregullimit të Territorit Tiranë është bërë ndryshimi në destinacionin e fushës sportive në Laprakë, pjesë e ish-Kompleksit Partizani. Rezulton se mes anëtarëve të KRRT-së, ishin vëllezerit Marin dhe Arben Bicoku, bashkëpunorë të ngushtë të dhëndrrit dhe vajzës suaj, por edhe bashkëshortes, të cilët janë gjuarmuar në udhëtime dhe mardhënie biznesi me Marin Bicokun. Marin Bicoku rezulton të ketë mbajtur në atë perjudhë edhe detyrën e Sekretarit të KRRTRSH-së, në kohën kur ky ka miratuar ndryshimin e destinacionit të fushave sportive në Laprakë. Po kështu, 2/3 e anëtarëve të këtij Këshilli të Rregullimit të Territorit Tiranë caktoheshin persona me detyra qeveritare. Si do e komentoit faktin që pikërisht njerëzit që vendosën fatin e fushave sportive të ish-Kompleksit Partizani rezultojnë në lidhje vartësie me ju e raporte biznesi me familjarë tuaj? Edhe këto fakte janë rastësore?

Se kush vendosi fatin e fushave sportive të ish-kompleksit të Klubit Partizani besoj se u sqarua shumë qartë me dokumenta zyrtare. Atë e vendosi Edi Rama me vartësit dhe firmën e tij qoftë në 2006 dhe qoftë në 2008.

Mendoj që referenca e pishinës në Laprakë është e gabuar. Nuk pretendohet në dosje dhe edhe sot aty nuk ka ndërtim. Nuk e di cili është destinacioni i zonës në fjalë. Çështja e destinacionit i referohet terreneve të tjera të KP dhe është ajo që kam shpjeguar më lart. Mbetem i hapur për çdo ballafaqim me dokumenta që provojnë ndryshe, ose sqarim të nevojshëm.

KRRTRSH nuk kishte të drejtë të propozonte apo të vepronte me nismën e vet dhe nuk ka vepruar kurrë. Ka miratuar ato projekte që i kanë sjellë KRRT e bashkive përkatëse.

Në lidhje me z. Arben Bicoku, me sa di unë, ka qenë bashkëpunëtor kryesor i Edi Ramës. Në dijeninë time ai nuk ka njohje me vajzën time apo dhëndrrin tim.

Në lidhje me z. Marin Bicoku (MB), në dijeninë time udhëtimet e tij me bashkëshorten time kanë qenë pas largimit të tij nga puna në administratën shtetërore. Ato lidhen me projektimin e Qendrës Rajonale të Autizmit nga ai si arkitekt privat dhe këtu nuk shoh asnjë problem.

Me Prof. Malltezi, z. Bicoku ka qenë qysh student në vitet '90 i aktivizuar në shoqata rinore për mjedisin dhe kanë ruajtur njohjen.

Lidhur me atë që thoni se 2/3 e anëtarëve të këtij Këshilli të Rregullimit të Territorit Tiranë në 2006 caktoheshin persona me detyra qeveritare, më duhet të them se kjo ishte si pasojë e ligjit të urbanistikës së 1998 të miratuar nga qeveria socialiste, apo edhe për këtë “Fajin e ka Saliu!” pse nuk e thotë këtë SPAK? Fill pas vendimit të GJK nr. 29 të datës 21.12.2006 kjo u zgjidh.

POR për më tepër, vendimmarrja në KRRT së bashkisë ishte e kushtëzuar nga projektet e sjella nga Këshilli Teknik (KT), që siç e thashë më lart, ishte i përbërë nga drejtorë të BT, vartës të Edi Ramës. Nuk kishte asnjë mekanizëm për ta detyruar KT të sillte një dosje në KRRT. Këshilli Teknik e miratoi ndryshimin e destinacionit në 12.05.2006 pa kërkesë dhe pa dijeni të pronarëve, madje këta të fundit 10 ditë më vonë lidhën kontratë me ndërtuesin duke ia kërkuar këtë shërbim ndërtuesit. Gjë që tregon se asnjë nga palët nuk kishte dijeni për këtë ndryshim. Edi Rama e futi menjëherë vendimin e KT për miratim në KRRT, ku anëtarët kanë votuar sipas bindjes së tyre në 2006. Kjo lidhur me ndryshimin e destinacionit prej 0.7 ha (7,000 m²) që më pas ia miratoi en-bloc KRRTRSH e kohës si një nga 11 ndryshimet e destinacioneve nga sportive në urbane që miratoi Edi Rama në 2006.

Më pas, në këtë tokë që vetë Edi Rama i kishte ndryshuar destinacionin, po Edi Rama lëshoi leje të sheshit të ndërtimit me numër 132, datë 29.12.2007, siç u tregua më sipër. Po këtë pse e fsheh SPAK?

Në ndryshimin e dytë të destinacionit (mbi 7 hektarë) në 2008, shumicën në KRRT e kishte vetë Edi Rama, i cili miratoi zonimin funksional të planit dhe e ktheu gjithë zonën e madhe në “Zhvillime të reja me parametra të lartë urban” përmes

vendimit nr. 238, datë 27.12.2008. Këtë vendim dhe hartën përkatëse SPAK e fsheh! PSE?

6 - Në mbledhjen e 18.06.2008 të Këshillit të Ministrave, ku u kalua VKM nr. 906/2008 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9376, datë 21.05.2005 “Për Sportin”, me propozim të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Ylli Pango (i cili mungonte), ju aluduat se ky i fundit kishte rënë pre e një lobimi të turpshëm nga disa “presidenta” për të bllokuar procesin e privatizimit të pronave nga pronarët e ligjshëm me disa ndryshime të bëra më herët mbi këtë ligj. Ndryshimet që ju miratuan me këtë VKM, nga ana tjetër, duke pasur parasysh pjesëmarrjen e z. Malltezi, a nuk ju ngarkojnë me të njëjtat akuza me të cilat ju etiketuat ish-ministrin tuaj, z. Pango?

Nuk kam aluduar në asnjë moment një gjë të tillë për z. Pango, por kam qenë i bindur se teksti ose ndoshta ndryshime të tij në moment të fundit kishin pasur shtysa të tilla. Nuk mund të shpjegohet ndryshe në këndvështrimin tim, miratimi i një ligji që bëhet i pazbatueshëm sepse bie ndesh në mënyrë flagrante me ligje të tjera (LKKP, neni 7 § 2), gjë që e kam vënë në dukje dhe në mbledhjen e qeverisë. Ndryshimet ligjore i nënshtrohen filtrave të vlerësimit të ekspertëve të teknikës legislative, që evitojnë përplasje të tilla. Fakti që këto filtra nuk funksionuan ishte tregues i një situatë jo të zakonshme.

Por në fakt, kërkojini prokurorëve politikë të japin të gjithë dokumentet dhe mos i fshehin. P.sh., sa për dijeni, z. Pango me korrektesë i ka dërguar ish-ministrit Ruli shkresën nr. 2519 prot., datë 09.04.2008, ku ka sqaruar se “këto terrene e objekte sportive prej shumë vitesh kanë humbur destinacionin e tyre të mëparshëm dhe zona në fjalë ka ndërruar destinacionin nga zonë sportive në zonë urbane me vendimin e KRT Tiranë nr. 132/j, datë 08.06.2006, i miratuar më pas nga KRTRSH me vendimin nr. 4, datë 21.11.2006”. Për më tepër, në atë tokë Edi Rama kishte firmosur edhe lejen e sheshit të ndërtimit, siç u shpjegua më sipër.

7 - Si i gjykoni pretendimet e SPAK se ju, z. Berisha, keni përdorur njerëz të besuar në Komisionet e Vlerësimit të dy Klubeve (Elvira Aliaj e Sali Preci), të cilët kanë bërë vlerësim fiktiv, duke ulur edhe vlerën faktike të tyre, që mundësuat blerjen - nga e cila përfitoi edhe dhëndrri juaj, gati 9-fish më të ulët?

Së pari, nuk është tagër i KM vlerësimi i klubeve apo caktimi i ekspertëve, por i komisionit të vlerësimit, i përbërë nga përfaqësues të qeverisë dhe bashkisë, në atë kohë e drejtuar nga Edi Rama. Komisioni zgjedh ekspertët.

Asnjërin prej dy ekspertëve nuk i njoh dhe nuk ka asnjë dokument në dosje që të provojë se këta persona kanë pasur njohje me familjarët e mi, e le më që të kenë qenë persona të besuar.

Pas pyetjes suaj jam informuar për çështjen e vlerësimit dhe më rezulton se metoda e vlerësimit të objekteve të privatizimit e ndjekur në atë kohë ka qenë plotësisht në përputhje me VKM në fuqi për kohën dhe me të gjithë standardet ligjore.

Për të provuar të kundërtën, prokuroria ka angazhuar ekspertë të cilët, sipas ligjit, jo vetëm nuk kanë tagrat ligjore për të bërë ekspertiza të tilla, por kanë dosje të hapura në prokurori për shkelje të ndryshme ligjore, gjë që i bën ata shantazhueshëm, e për rrjedhojë jo të pavarur.

Vetëm kjo mund të shpjegojë për shembull çudi të tilla (për të cilat jemi informuar nga akuza) kur objekte e KP të ndërtuara në vitin 1970 dhe që sot nuk ekzistojnë (pra në momentin e ekspertizës nga ekspertë të SPAK nuk kanë ekzistuar), janë vlerësuar nga ekspertët e SPAK, sipas vlerave reference për kostot e ndërtimit të ri të vitit 2007!!! (shih fq. 194 të akuzës JM, fq. 200 akuza SB).

Ndoshta është kjo arsyeja që SPAK nuk na ka vënë në dispozicion këto ekspertiza kur janë hartuar.

Fatmirësisht ka dëshmitarë, fotografi dhe filmime të gjendjes së mjerruar që ishte aty dhe ku banonin 42 familje informale. Por janë dhe deklaratat publike dhe dokumentet me firmën e Edi Ramës në të cilat ai konfirmon se objektet kanë dalë jashtë funksionit (shih grupin e foto8 bashkangjitur). Zhvilluesit fisnikë nuk nxorën asnjë familje jashtë, por i zgjidhen me mirëkuptim dhe i ofruan strehim atyre familjeve.

8- Z. Berisha, me firmën tuaj keni miratuar VKM nr. 1638 dt 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet ose transformohet dhe procedurën e shitjes”, hyrë në fuqi me dt. 31.12.2008. Ky vendim i lejoi ish- pronarët të përballonin kostot e privatizimit duke paguar me bono privatizimi. Më specifikisht, rezulton se pas këtij vendimi, grupi i ish-pronarëve ku bën pjesë edhe z. Malltezi kanë mbyllur pagesat për privatizimin, ndërsa këstin e parë e kishin paguar në lekë. Po kështu na rezulton, se me VKM nr. 738 dt 01.07.2009, kjo procedurë është revokuar po

me firmën tuaj, Z. Berisha. Edhe kjo është një ngjarje e rastësishme në morinë e procedurave ligjore që ju keni administruar, kur ndër përfituesit e faktuar është grupi i ish- pronarëve mes të cilëve dhëndri juaj?

Mashtrim dhe fallsifikime!

Arsyet e miratimit të VKM 1638 i shpjegova më lart. Edhe sot qeveria ka bërë zgjatje të afatit të përdorimit të bonove të privatizimit.

Çështja e ndryshimit të pretenduar nga SPAK me anë të VKM 738, është një falsifikim, për të cilin sot JM ka bërë kallëzim penal kundër prokurorëve.

Kini parasysh që ky pretendim, në bazë të të cilit qëndronte falsifikimi i SPAK, ishte në bazë të kërkesës së prokurorisë për vendosjen e masës së arrestit ndaj JM dhe masave të tjera të sigurisë ndaj meje në 20.10.2023. Në vendimin e GJKKO që vendosi këto masa të kufizimit të lirisë arsyetohet se: **“Ky parashikim nënligjor ka shërbyer posaçërisht për realizimin e interesave të pesë familjeve pronare, pasi vetëm 7 (shtatë) muaj më vonë, me VKM nr. 738 datë 01.07.2009, të po këtij Këshilli, pika 26 e kapitullit III ka ndryshuar përsëri, duke u përcaktuar se pagesa bëhet vetëm me lekë, duke përjashtuar mundësinë e pagesës me bono thesari.”** (fq. 185, vendimi nr. 112, 20.10.2023, GJKKO).

Ndërkohë që ky pretendim është një gënjeshtër e pastër, një falsifikim. Ju mund të verifikoni vetë akuzën dhe VKM-në në fjalë për të parë që ndryshimi i sjellë me VKM nr. 738 nuk afektonte parashikimin për pagesat nga ish-pronarët (§26(ii)), por vetëm blerjet me ankand (§26(i)), ndërkohë që në akuzë dhe vendime gjyqësore pretendohet se pikërisht kjo dispozitë që u miratua për t’i ardhur në ndihmë pronarëve u shfuqizua menjëherë sapo realizoi qëllimin. Theksoj përsëri se ky vendim u firmos disa javë pasi familjet pronare kishin paguar me lekë në bankë 90% të detyrimeve dhe dhëndri im përfitoi nga ky vendim 62 euro.

9 - Z. Berisha, sipas dosjes së SPAK dhe dëshmisë së dhënë nga ish-Komandanti i Komandës Mbështetëse Vladimir Qiriazhi, thuhet se Ministri i Mbrojtjes, Gazment Oketa, i ka bërë atij presion në mars të viti 2009 për të firmosur shitjen e KF Partizani, duke aluduar se urdhri vinte nga ju. Më pas rezulton se, më 16.04.2009, ë kohën që atij i kërkohej me këmbëngulje të firmoste, ju keni urdhëruar një kontroll tematik për procedurat që Qirazi kishte ndjekur për dorëzimin e pronës 11, KF Partizanit.

A keni ndonjë koment për këtë akzuë të z. Qirjazi dhe a ishit ju në konflikt interesi kur urdhëruat një procesi auditimi për një rast specifik, ku rasti në fjalë lidhej me një çështe ku z. Malltezi kishte një interes direkt?

E vërteta është se Z. Qirjazi nuk ka pasur asnjë rol për shkak të funksionit të tij në privatizimin e KFP. Detyra e tij, që prej emërimit, ka qenë të merrte në administrim KFP dhe ta administronte me përgjegjësi dhe në interesin më të mirë të shtetit. Qysh në vitin 2000 ish-ministri socialist Ismail Lleshi kishte urdhëruar komandën mbështetëse të merrte në dorëzim pronën e KP dhe ta vinte atë nën administrimin e shtetit, pra të vileshte të ardhura për buxhetin e shtetit nga kjo pronë. Por ky urdhër u injorua vazhdimisht, edhe pas kërkesave të shefit të shtabit, gjen. Qazimi gjatë viteve 2005-2006. Përkundër kësaj drejtoria e Mbështetjes ka lejuar vijimësinë e paligjshmërisë, duke lejuar shfrytëzimin e ambienteve të KFP për qëllime tregtare nga subjekte të tjera, pa lidhur kontratë me shtetin. Se çfarë interesi mund të ketë një zyrtar i shtetit që ta bëjë këtë, mbetet besoj e lehtë për t'u imagjinuar.

Pikërisht sepse mesa duket kjo situatë kishte qenë e kënaqshme për z. Qirjazi, ai refuzonte të bënte dorëzimin e pronës, në një kohë kur privatizimi kishte përfunduar dhe pronarët kishin bërë prej një viti pagesën shtetit për objektet e parablëra. Me qëndrimet e tij të paligjshme z. Qirjazi vonoi për gati një vit dorëzimin e pronës, pas pagesës së saj, gjë që sipas ligjit detyronte shtetin t'u paguante qera pronarëve.

Unë kam urdhëruar kontrollin në bazë të një ankese të ardhur në departamentin e antikorrupsionit, siç bëja me shumë praktika të tjera. Nuk kam urdhëruar diçka që ishte jashtë kompetencave të mia, apo që të binte në kundërshtim me ligjin. Përkundrazi, ndërprerja e paligjshmërisë dhe evitimi i dëmeve ndaj buxhetit të shtetit ishin detyrë e imja.

Ndryshe nga sa është pretenduar për shkarkimin e tij, ai nuk është shkarkuar por është lëvizur në detyrë paralele. Qirjazi është larguar nga detyra nga qeveria socialiste.

Pretendimet e ngritura nga z. Qirjazi për presion janë kundërshtuar nga dëshmitarë të tjerë (z. Oketa, etj.). Z. Qirjazi do të ketë mundësi t'i ballafaqojë ato në gjykatë, por besoj midis deklaratës së një ministri, që është njësoj me atë të shumë dëshmitarëve të tjerë, dhe deklaratës së një ish-zyrtari, që ka qenë i prekur nga

ndërprerja e paligjshmërisë mbi objektet shtetërore, çdokush mund të besojë atë që dëshiron.

10- Në dosjen e hetimit të SPAK z. Malltezi rezulton si përpiluesi i letrës me objekt “Njoftim për keqpërdorim funksioni zyrtar” në emër të 5 familjeve ish-pronare, e cila ngre akuza për korrupsion ndaj z.Vladimir Qiriazit. Kjo letër nuk gjendet e arkivuar në Kryeministri referuar hetimit të SPAK. Kjo letër u përdor nga Zyra Anti-korrupsion në Kryeministri, - ku njëri prej inspektorëve të caktuar për verifikim rezulton edhe trashëgimtar me pjesë takuese në ish-Kompleksin Partizani, - për fillimin e kontrollit ndaj punës së ish-Komandantit. A nuk përbënte konflikt interesi hetimi nga Zyra e Kryeministrit, që ju drejtonit, të një ankese të ardhur nga dhëndri juaj?

Mjafton kjo mënyrë të shprehurit për të kuptuar që aktakuza nuk është një dokument ligjor por një pamflet politik. Kjo nuk ka ndodhur kurrë dhe pretendimi është shpifja e radhës. Si mund ta thotë këtë SPAK kur nuk ka asnjë mënyrë për ta vërtetuar. JM nuk është një nga nënshkruesit e letërës. Letra nuk është shkruar me shkrim dore. Ajo mund të ishte bërë nga cilido prej pronarëve të tokës, pasi kishte tagër ta kërkonte personalisht. Si mund të provohet mosveprimi i z. Malltezi?

Për më tepër, letra është firmosur nga 5 pronarë të tokës dhe jo nga Jamarber Malltezi. Dy prej tyre kanë pranuar se është firma e tyre por nuk i kujtohej teksti pasi ka kaluar 15 vjet dhe për këto procese janë shkruar me qindra letra. Ata kanë shkruar se ka keqpërdorim funksioni zyrtar nga dikush në ministrinë e mbrojtjes dhe jo nga z. Qirjazi, gjë që tregon se këta pronarë po vërejnë vonesa shumë mujore por nuk dinin se kush po e bllokonte. Ata gjithashtu i kanë shkruar se me këto vonesa qeveria detyrohej të paguante qira sipas ligjit, gjë që ka detyruar qeverinë të reagoje dhe pas auditimit doli se pronarët kishin të drejtë në pretendimet e tyre.

SPAK pretendon se nuk ka gjetur gjurmë të letrës në fjalë në arkivin e KM. Sigurisht që unë nuk marr me vete arkivin e KM dhe nuk mund të them se si janë mbajtur dosjet në arkiv, por nga leximi i akt-akuzës është e dukshme që ky është justifikimi i preferuar i SPAK sa herë ka nevojë të mbulojë fallsifikimet e veta. Kështu p.sh. të njëjtin justifikim SPAK përdor në mënyrë konveniente edhe në lidhje me mungesën e procesverbalit të mbledhjes së KM mbi ndryshimin e sjellë me VKM 738 (të sipër-përmendur). Edhe për këtë akt, për të cilin në fakt rezulton se SPAK ka bërë fallsifikim të dokumentit zyrtar të akuzës, SPAK deklaron se nuk e ka gjetur në arkivin e KM (shih fq. 257, aktakuza SB). Procesverbali mbahej nga dy stenografiste dhe zbardhej dhe kurrë nuk ka pasur mbledhje pa procesverbal.

Në lidhje me zyrtarin e zyrës së Antikorrupsionit që ka rezultuar të ketë lidhje me familjen Begeja, drejtuesi i Departamentit z. Bylykbashi ka dhënë sqarimet e tij në dosje dhe ka thënë që ka qenë ai që ka bërë caktimin e personit në detyrë, por nuk e ka ditur këtë lidhje me pronën në momentin e caktimit. Sipas ligjit i takonte zyrtarit në fjalë që ta deklaronte këtë fakt dhe ai nuk e ka bërë për arsyet e shpjeguara nga ai vetë. Megjithatë, kontrolli bazohej në dokumenta dhe afate ligjore të shkelura, siç shpjegova më lart, të cilat SPAK nuk ka mundur t'i kundërshtojë, ndaj asgjë nuk do ta ndryshonte rezultatin e vlerësimit.

11 - A ka fakte konkrete për korrupsionin apo ndikimin e përfaqësuesve të shoqërisë aksionere Klubi i Futbollit Partizani tek ish-Komandanti Vladimir Qiriaz, për të cilin është aluduar edhe në Raportin e inspektorëve të Zyrës Anti-Korrupsion në Kryeministri?

Faktet janë ato më sipër. Ka shkresa zyrtare të ministrit Ismail Lleshi që në vitin 2000 ku kërkohej marrja e pronës në administrim shtetëror, si dhe shumë letra vijuese nga zyrtarë të tjerë (shih foto 9 bashkëngjitur), përfshi ish-shefin e shtabit Qazimi. I takonte SPAK të hetonte për këtë gjë. Pyetja është pse SPAK nuk e ka bërë këtë. Përkundrazi, SPAK ka tentuar të legjitimojë paligjshmërinë.

12 - Sipas Auditit të kryer me urdhrin n.900 të datës 02.07.2014 të Ministres së Mbrojtjes, Mimi Kodheli - në të cilat SPAK ka fituar akses përmes Kol.Fejzo Haxhia në mungesë të një raporti zyrtar thuhet - arrihet në përfundimin se familja Begeja duhet të jetë shpronësuar nga Mbretëria Italiane, pasi nuk gjenden dokumenta të zotërimit të pronës nga kjo familje pas 1943, kur zhvillohej procedura e shpronësimit, e as dëshmi të shtetëzimit të kësaj prone pas çlirimit.

Si ish-Kryeministër i vendit, a ndjeni ju ndonjë përgjegjësi sikur administrata e drejtuar prej jush t'i këtë kthyer pronën një familje, pa shqyrtuar gjithë dokumentacionin e duhur, sic e referon edhe Auditi apo edhe dëshmon kolonel Haxhia?

Edhe ky është një pohim i rremë, i kundërshtuar nga ligje të botuara në fletore zyrtare. Në qoftë se dikush merr përsipër të rrezojë ligje me dëshmi të rreme, kryen një krim.

Besoj ju ka tërhequr vëmendje fakti, që siç del nga akt-akuza SPAK pretendon se e

ka parë CD por nuk e ka bërë pjesë të dosjes. Ministria Kodheli dhe vartës të saj, zyrtarë të lartë të MM, të pyetur në këtë çështje, në mënyrë konveniente kanë thënë që nuk e kujtojnë rezultatin e auditit, dhe se nuk e dinë fatin e dokumentit të auditit. Ne do ta kërkojmë administrimin e CD në fjalë për të kuptuar abuzimin e tmerrshëm dhe përdorimin politik të SPAK për mbi një vit.

Kini parasysh që ky pretendim ka qenë thelbësor në kallëzimin e rremë të Taulant Ballës dhe një nga arsyet për të cilat unë dhe JM jemi në arrest që prej gati një viti.

Prokuroria e ka ditur dhe ka pasur mundësi ta dinte të vërtetën që në ditën e parë, por me urdhër politik ka fshehur atë dhe dokumentat zyrtare dhe ka refuzuar padinë për kallëzim të rremë ndaj Taulant Ballës.

Pas hetimeve 4-vjeçare, hulumtimeve disa mujore deri në letërkëmbime në Arkiv të Shtetit dhe letërporosive në Itali, SPAK u detyrua të pranojë që kjo deklaratë ishte **mashttrim dhe se fletoret zyrtare të kohës kanë botuar dekretet ligjore të cilat tregonin se prona e pesë familjeve pronare ishte nën masën e refuzimit të përkohshëm në 1942 dhe 1943, në momentin e kapitullimit të Italisë dhe pra nuk ishte e shpronësuar** (shih foto 10 bashkëngjitur). Dokumenta të arkivit Teknik dhe atij qendror RSH, tregojnë qartë pronën që Italia kishte projektuar për zgjerimin e aeroportit, matjet e tokave, si dhe aktet ligjore përkatëse. Por përtej çdo dyshimi janë Fletoret Zyrtare të kohës që janë të aksesueshme në internet (BKSH) dhe që tregojnë gjendjen ligjore të tokës.

A mendoni ju që nuk e dinin këtë gjë që në fillim prokurorët e korruptuar dhe të kapur politikisht? Sigurisht që e dinin, se gjëja e parë që kontrollon juristi është fletorja zyrtare, ligji. Por fillimisht ishte urdhri politik që diktoi burgosjen e paligjshme të Malltezit dhe Berishës për qëllime dhe interesa të pastra politike. Tani është frika ku janë ngërthyer prokurorët e SPAK për shkak të veprave penale që kanë kryer, fshehjes së krimit – kallëzimit të rremë të Taulant Ballës, ajo që i detyron ata, që nga një anë të pranojnë se toka nuk ka qenë e shpronësuar, por nga ana tjetër të argumentojnë në rreth 100 faqe pse e kanë patur të paqartë pronësinë e tokës.

Pra asnjë paqartësi nuk ka titulli i pronësisë. Familjet pronare kanë dhe kanë dorëzuar edhe dokumentat që tregojnë se e kanë pasur në pronësi pronën në vitin 1945 (shih foto 11 bashkëngjitur). Për fat të keq keqpërdorimi politik i SPAK është kaq i pabesueshëm sa ç'duket. Është vështirë për një mendje të shëndoshë të kuptojë se çfarë i shtyn prokurorët të rrezikojnë kriminalizimin e tyre në këtë mënyrë. Përgjigja e vetme është pengmarrja e tyre.

13 - Sipas dosjes hetimore, z. Berisha, akuza më e rëndë ndaj jush është ajo e korrupsionit. Organi I akuzës ka rënditur disa prova, nëpërmjet të cilave argumenton se ju personalisht jeni përfituesi i zhvillimit të ish-Kompleksit Partizani, aktivitet që ka buruar nga ndryshimet ligjore që ju keni ndërmarrë në krye të detyrës.

Me konkretisht thuhet se këni përfituar:

- rreth 470 000 Euro e 153 837.61 USD në mbulim shpenzimesh për arsye të ndryshme (shpenzime ligjore për procedet tuaja gjyqësore të hapura jashtë Shqipërisë, shpenzime shëndetësore, pushime etj.), të likujduara nga cifti Malltezi;

- rreth 8 599 647.6 Lekë, 24 171 Euro dhe 8 225.89 USD të paguara nga familja Malltezi për llogari të fondacionit Scaglione, të drejtuar nga bashkëshortja juaj Liri Berisha;

- rreth 676 250 Lekë, për këngëtarin Riçardo Coçiante në funksion të fushatës suaj zgjedhore, paguar nga shoqëria investitore në ish-Kompleksin Partizani, Homeplan shpk, - me aksioner z.Bektashi dhe, sipas hetimeve, edhe z. Malltezi rezulton aksioner qysh atë vit.

Me këto shuma të përfituara prej jush, z. Berisha, a gjendeni në kushtet e përfitimit, cka mund të vërtetojë edhe akuzën për korrupsion?

Së pari, në lidhje me kualifikimin e vepres nga SPAK. Një vepër penale nuk ka nevojë 500 faqe për t'u shpjeguar. Mjaftojnë dy faqe në të cilat tregohet 1. data e kryerjes, 2. përfitimi i ardhur, 3. koha e ardhjes së tij dhe 4. lidhja shkak-pasoje.

SPAK nuk thotë asnjë nga këto. Shpif kur thotë që kam ndryshuar destinacionin kur këtë e ka bërë Rama dhe unë e kam kaluar ex lege, sic përcaktonte vendimi i Gjykatës Kushtetuese, respektivisht 6 muaj dhe 5 vjet pas Ramës.

Shpif kur thotë kam ndryshuar ligje për të favorizuar dhëndrin dhe hyn në vlerësimin e tyre, që është cenim i rëndë i parimit të ndarjes së pushteteve në një shtet të së drejtës, dhe del se ligjet janë programatike, sektoriale dhe jo për grupe apo individë, del se ndryshe nga sa pretendon SPAK ligjet nuk kanë ndryshuar ose ndryshimet e tyre nuk kanë patur efekt. Pra e gjithë kjo është një piramidë mashtrimi.

Të tilla janë edhe përfitimet e pretenduara.

Sipas SPAK unë kam bërë ndryshime destinacioni në 2006 dhe 2013 në mënyrë që subjekti privat Homeplan (HP), i përfaqësuar nga administratori i tij të bëjë një donacion që ka hyrë në buxhetin e një Ministrie. Cili është përfitimi im këtu? Këngëtari në fjalë nuk erdhi për fushatë elektorale, dhe siç pashë në akt-akuza as që kishte kënduar diku. Erdhi dhe mori një dekoratë nga Presidenti i Republikës, pati një takim me ministrin e linjës dhe me mua dhe u largua. Unë kam pasur përfitim këtu aq sa çdo shqiptar.

SPAK kërkon ta pasqyrojë solidaritetin familjar si korrupsion dhe përmend fatura shëndetësore të miat apo gruas sime të paguara nga imë bijë, apo dhëndri. Llogaritë e mia bankare administrohen nga vajza ime dhe unë i kam kërkuar asaj që të marrë aty paratë që nevojiten. Ajo nuk e ka bërë sepse e ka konsideruar pjesë të solidaritetit familjar që ekziston në çdo familje shqiptare. E njëjta gjë vlen për 3000 euro të paguara gjatë një pushimi të përbashkët familjar nga ata.

Po ajo që ka rëndësi është se këto shpenzime janë deklaruar në momentin që janë bërë në ILDKPI dhe burimet janë plotësisht të ligjshme të kontrolluara.

Po këtu theksoj, meqë nuk ishte më lart në një nga pyetjet tuaja, se të ardhurat e dhëndrit tim nga aktiviteti i ndërtimit të KP janë tërësisht të ligjshme, të gjeneruara në përputhje të plotë me çdo ligj të vendit, të deklaruar sipas regjimit ligjor në fuqi dhe të taksuara. Ai kurrë nuk ka marrë para cash të padeklaruara nga ky aktivitet. Kjo provohet nga ekspertiza kontabel e hartuar nga ekspertë të pavarur që SPAK ka refuzuar ta pranojë si provë sepse rrezonte piramidën e saj të mashtrimit.

Përsa i përket pagesave për shpenzime gjyqësore, ato nuk janë nga të ardhurat e zhvillimit të KP, por nga burimet e deklaruar të të ardhurave të vajzës sime, për procese ku dhe ajo është palë, ose ka interesa indirekte. Ka veç 1 pagesë për gjyqin në Francë që është paguar nga JM dhe kjo është hua, e deklaruar sipas ligjit në ILDKPI. Këto janë procese dhe fatura në zhvillim dhe për këtë arsye janë për momentin hua dhe janë deklaruar rregullisht.

Pagesat që vajza dhe dhëndërrim im kanë bërë për fondacionin Fëmijët Shqiptarë, të drejtuar nga gruaja ime, janë pagesa zekat për bamirësi që ata i kanë bërë në mënyrë të përvitshme tre familjeve në nevojë, për trajtimin e 3 fëmijëve me autism pranë Qendrës Rajonale të Autizmit. Asnjë nga ato pagesa nuk ka shkuar për

përfitimin tim apo të bashkëshortes sime, sepse pagesat kanë shkuar direkt për trajtimin e fëmijëve, **ndërkohë që bashkëshortja ime, që prej ditës së marrjes së drejtimit të fondacionit e deri më sot, nuk ka marrë asnjë qindarkë pagese apo shpërblim për punën e saj në këtë fondacion.**

Cila logjikë e shëndoshë e konsideron bamirësinë përfitim në kuptimin e Kodit Penal?

Por këtu nuk mund të mos them që pjesë e këtyre hetimeve, siç rezulton nga dosja, ka qenë dhe vetingu financiar 30-vjeçar i Sali Berishës që tregoi se ai dhe e shoqja mjeke, Dr. Liri Berisha, disponojnë 100 mijë euro kursime për 54 vite pune dhe një apartament me sipërfaqe banimi 40 m² më të madhe se atë që kanë patur në diktaturë.

Ky veting veretoi gjithashtu se fëmijët e mi, nuk kanë përfituar kurrë nga fonde apo kontrata publike, se kanë pasur të ardhura të ligjshme nga ato burime që kanë deklaruar dhe se kanë ushtruar profesionet e tyre në përputhje me ligjin.

Ky veting 30-vjeçar ishte një përgjigje shterruese ndaj atyre që mbi baza të lobimit korruptiv të Edi Ramës dhe mentorit të tij George Soros shpallën Sali Berishën, bashkëshorten dhe fëmijët e tij non grata për korrupsion domethënës, pa asnjë provë, fakt apo dokument.

Kështu që, si përfundim, kjo aktakuzë është monumenti më i shëmtuar i pengmarrjes së drejtësisë shqiptare nga korrupsioni politik shqiptar dhe ndërkombëtar.